

VENDIM
Nr. 171, datë 31.7.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW**

(Ndryshuar me vendimin nr. 280, datë 6.11.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1841/6 prot., datë 25.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841 prot., datë 10.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 30 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 24.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.6.2025 dhe 26.6.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.7.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1841/3 prot., datë 26.6.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën nr. 1841/4 prot., datë 26.6.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës së licencimit, duke i kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/5 prot., datë 4.7.2025, ka depozituar informacionin/dokumentacionin plotësues për këtë aplikim.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.4.2025 është miratuar *ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k.*

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3038, Njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k.”.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 13.2.2025, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 30 MW.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n me nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, parashikon një afat 49-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë teknike të jetëgjatësisë së centralit me afat vlefshmërie 30-vjeçare, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit fotovoltaike me rrjetin e transmetimit, rezulton se shoqëria është brenda afatit të përcaktuar në miratimin në parim të dhënë nga OST sh.a., nëpërmjet shkresës së datës 10.2.2025, por duke qenë se nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar apo nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse, duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaike, lidhja e tij me rrjetin elektrike është e garantuar, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 13.2.2027, e cila ndodhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n, ku përcaktohet se duhet të ndërtojë dhe të vendosë në punë centralin brenda datës 30.4.2028.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 30 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shfuqizuar.

3. Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. duhet të fillojë operimin e centralit fotovoltaiik jo më vonë se data 31.12.2025.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti